



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:159066

Datë: 12.09.2023

Numri i dokumentit: 04672012

**PS.nr. 33/2021**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI SPECIAL**, trupi gjykues në përbërje nga gjyqtarët Suzana Çerkini, kryetare, Violeta Namani dhe Vesel Ismaili anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vanesa Rama, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.B., nga Prishtina, V.M., nga fshati K., Komuna Obiliq, A.A., nga fshati N., Komuna Obiliq dhe A.T., nga Prishtina, për vepër penale Shpërlarja e parave nga neni 302 i KPRK 06/L-074 lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit, të akuzuar me aktakuzë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.63/20 të dates 16.08.2021, pas shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun të mbajtur me data 19.07.2022, 29.09.2022, 07.10.2022, 10.10.2022, 24.10.2022, 27.10.2022, 22.11.2022, 14.12.2022, 16.12.2022, 28.03.2023, 18.04.2023, me praninë e prokurorit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës Naim Abazi, të akuzuarve A.B., me mbrojtësin av.Florent Latifi sipas autorizimit, V.M me mbrojtësen av.Teuta Zhinipotoku sipas autorizimit, A.A., me mbrojtësen av.Behar Ejupi sipas autorizimit dhe A.T., me mbrojtësin av.Sahadete Gashi sipas detyrës zyrtare, me datë 24.04.2023 mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

1. **A.B.**, i lindur më //// në Prishtinë, nga i ati E dhe e ëma Sh, me vendbanim në Prishtinë, në rr. “//”, kompleksi “//”, nr./, i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën fillore dhe tri vite e gjysmë shkollë të mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ////.
2. **V.M.**, i lindur më //// në fshatin K/, Komuna e Obiliqit, nga i ati V dhe e ëma M, me vendbanim në fshatin Sh, Komuna Obiliq, te lagjja e re, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ///.
3. **A.A.**, i lindur më ////, në Fushë Kosovë, nga i ati A dhe e ëma S, me vendbanim në fshatin N., Komuna e Fushë Kosovës, rr. “//”, p.nr., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ///.
4. **A.T.**, i lindur më ////, në fshatin R..., Komuna e Pejës, nga i ati A dhe e ëma F, me vendbanim në Prishtinë, në Lagjen ///, llam.///, nr.///, i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ///, gjendet në vuajtje të dënimit për një vepër tjetër penale.

Konform nenit 363 par.1 nënpar. 1.3 të KPP,

### **LIROHEN NGA AKUZA**

**I. Sepse**, i akuzuari **A.B.**, në periudhën kohore nga viti 2013 deri në vitin 2014, duke qenë në dijeni se paratë burojnë nga aktiviteti kriminal dhe me qëllim të përFit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ka pranuar shuma të mëdha të mjeteve monetare nga personat e panjohur nga Republika e Turqisë dhe Republika Domenikane, me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë së tij, në atë mënyrë që fillimisht i ka tërhequr mjetet monetare në shumë 97,990.47 euro, e më pas për t’i realizuar qëllimet e tij ka autorizuar edhe persona të ndryshëm për tërheqjen e shumave të

ndryshme të mjeteve monetare në emër të tij, përmes institucioneve financiare “Western Union” dhe “Money Gram”, në Kosovë, në shumë të përgjithshme 558,375.77 euro të cilat para rrjedhin nga aktiviteti kriminal.

- Nuk është provuar se ka kryer veprën penale Shpërlarja e parave nga neni 302 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës lidhur me nenin 56 par.1, nënpar.1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit.

**II. Sepse**, i akuzuari **V.M.**, në periudhën kohore nga viti 2013 deri në vitin 2014, duke qenë në dijeni se paratë burojnë nga aktiviteti kriminal dhe me qëllim të përFit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ka pranuar shuma të mëdha të mjeteve monetare nga personat e panjohur nga Republika e Turqisë dhe Republika Domenikane, me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë së tij, në atë mënyrë që i ka tërhequr mjetet monetare në shumë 49,037.40 euro, e më pas ka autorizuar edhe personat të ndryshëm për tërheqjen e shumave të ndryshme të mjeteve monetare në emër të tij, përmes institucioneve financiare “Western Union” dhe “Money Gram”, në Kosovë, në shumë të përgjithshme 123,348.79 euro të cilat para rrjedhin nga aktiviteti kriminal,

- Nuk është provuar se ka kryer veprën penale Shpërlarja e parave nga neni 302 i KPRK 06/L-074 lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit,

**III. Sepse**, i akuzuari **A.A.**, në periudhën kohore nga viti 2013 deri në vitin 2014, duke qenë në dijeni se paratë burojnë nga aktiviteti kriminal dhe me qëllim të përFit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ka pranuar shuma të mëdha të mjeteve monetare nga personat e panjohur nga Republika e Turqisë dhe Republika Domenikane me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë së tij, ka angazhuar persona të ndryshëm për tërheqjen e shumave të ndryshme të mjeteve monetare në emër të tij, përmes institucioneve financiare “Western Union” dhe “Money Gram” në Kosovë, duke pranuar dhe maskuar shumën totale prej 65,884.44 të cilat para rrjedhin nga aktiviteti kriminal,

- Nuk është provuar se ka kryer veprën penale Shpërlarja e parave nga neni 302 i KPRK 06/L-074 lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit.

**IV. Sepse**, i akuzuari **A.T.,,** në periudhën kohore nga viti 2013 deri në vitin 2014, duke qenë në dijeni se paratë burojnë nga aktiviteti kriminal dhe me qëllim të përfit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ka pranuar shuma të mëdha të mjeteve monetare nga personat e panjohur nga Republika e Turqisë dhe Republika Domenikane me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë së tij, në atë mënyrë që ka angazhuar persona të ndryshëm për tërheqjen e shumave të ndryshme të mjeteve monetare në emër të tij, përmes institucioneve financiare “Western Union” dhe “Money Gram”, në Kosovë, duke pranuar paratë në shumën totale 95,189.86 euro, të cilat para rrjedhin nga aktiviteti kriminal,

- Nuk është provuar se ka kryer veprën penale Shpërlarja e parave nga neni 302 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit.

- Shpenzimet e procedurës penale dhe pasushallit gjyqësor bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate,

## **A r s y e t i m**

### **1. Historiku i procedurës**

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me aktakuzën PPS.nr.63/2020 të datës 16.08.2021, ka akuzuar A., B., V.M.,n, A.A.,n dhe Arton Tahiranj për veprat penale Tregtia e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK dhe Shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK lidhur me

nenin 56 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit 05/L-096 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit.

Gjykata përkatësisht Departamenti Special kompetent për të vendosur për aktakuzat e PSRK, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar ka mbajtur shqyrtim fillestar në të cilin të akuzuarit e lartshënuar kanë mohuar fajsinë për veprat penale me të cilat i ngarkon aktakuza, më pas mbrojtësit e të njëjtëve kanë parashtruar kërkesa për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, ndërsa kjo gjykatë me Aktvendimin PS.nr.33/21 të datës 13.12.2022 ka refuzuar kërkesat e mbrojtësve. Në procedurë të ankimimit ndaj aktvendimit të kësaj gjykate, ka vendosur Gjykata e Apelit e cila me aktvendimin PN.S.nr.2/2020 të datës 27.01.2022 ka ndryshuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që ka Hudhë poshtë pjesërisht aktakuzën PPS.nr.63/20 të datës 16.08.2021 dhe atë, për pikën I të aktakuzës për secilin të akuzuar, përkatësisht për veprën penale Tregtia e ndaluar nga neni 305 par.2 të KPRK dhe ka pushuar procedurën penale ndaj të njëjtëve për këtë vepër penale.

Gjykata, ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor ndaj katër të akuzuarve të lartshënuar vetëm sa i përket veprës penale Shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit 05/L-096 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit, të precizuar në pikën II të aktakuzës për secilin të akuzuar. Pas leximit të aktakuzës (*pikës II*) për secilin të akuzuar nga prokurori i çështjes, gjykata i vuri të akuzuarit në dijeni për përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësis, mori deklaratimet e të akuzuarve të cilët në prani të mbrojtësve pas konsultimit të mjaftueshëm, në mënyrë të vullnetshme u deklaruan se nuk ndihen fajtor për veprën penale e cila u vihet në barrë, andaj gjykata vazhdoi me paraqitjen e fjalëve hyrëse të palëve për të vazhduar me rradhën e paraqitjes së provave, dëgjoi dëshmitarët, pastaj administroi provat materiale të prezantuara nga prokurori i çështjes, mëpas vetëm i akuzuari A.T., ka paraqitur mbrojtjen ndërsa të akuzuarit tjerë kanë shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje dhe në fund, ka pasuar paraqitja e fjalëve përfundimtare të palëve.

Prokurori nga PSRK në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë pikës II të aktakuzës për secilin të akuzuar - Shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit 05/L-096 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Ndërsa gjithë mbrojtësit e të akuzuarve në fjalën përfundimtare kanë paraqitur pretendimet e tyre duke kërkuar nga gjykata që të mbrojturit e tyre të lirohen nga akuza për veprën penale që u vihet në barrë sipas akuzës, duke vlerësuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar teza e

akuzës, ndërsa secili i akuzuar ka mbështetur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të vet duke mos shtuar asgjë më tepër.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të çështjes dhe për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm, gjykata ka rihapur shqyrtimin gjyqësor me datë 20.12.2022 për plotësimin e procedurës së provave, duke urdhëruar sipas detyrës zyrtare një ekspertizë financiare për të sqaruar çështjen e dërgesës së mjeteve monetare nga Republika Domenikane dhe Turqia vetëm për periudhën kohore sipas aktakuzës.

## **2. Paraqitja e provave në shqyrtim gjyqësor**

Meqenëse të akuzuarit nuk pranuan fajsinë për veprën penale Shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit 05/L-096 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit, gjykata për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, vazhdoi me procedimin e çështjes dhe shtjellimin e provave të paraqitura në shqyrtim gjyqësor.

### **Dëshmitë e dëshmitarëve**

Në këtë proqes gjyqësor nga përfaqësuesi i akuzës fillimisht për të dy veprat penale të aktakuzës janë propozuar gjithësejt 21 dëshmitar, për dëgjimin e të cilëve ka qëndruar edhe pasi ka mbetur vetëm një pikë e akuzës për secilin të akuzuar.

Dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtim gjyqësor janë: G.S., e L B<sup>1</sup>, B.D e F K.,<sup>2</sup> Xh.G., B.G, B.P.,, A.Sh e A.Z.,<sup>3</sup> F.Sh., N.B, P.R.,, F.B.,, M.B.,, S.S, Y.J.,e S.L.,<sup>4</sup> A.Z., e Sh.A.,<sup>5</sup> A.Th e E.Z<sup>6</sup>.

Vlenë të theksohet se tre dëshmitarët e parë as që kanë potencuar çfarëdo njohje apo lidhje tjetër me të akuzuarit dhe nuk kanë pohuar asnjë veprim që ndërlidhet me objektin e akuzës, që do të thotë nuk kanë qenë fare dëshmitar relevant të çështjes së të akuzuarve.

<sup>1</sup> Proqesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 19.07.2022

<sup>2</sup> Proqesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 29.09.2022

<sup>3</sup> Proqesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 07.10.2022

<sup>4</sup> Proqesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 10.10.2022

<sup>5</sup> Proqesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 24.10.2022

<sup>6</sup> Proqesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 27.10.2022

Sa i përket dëshmitarëve të tjerë, të gjithë pa përjashtim kanë pohuar tërheqjen e parave gjatë viteve 2013, 2014 apo edhe gjatë vitit 2015<sup>7</sup> nga institucionet financiare “Western Union” (*tutje WU*) dhe “Money Gram”(*tutje MG*) në Prishtinë dhe atë, disa herë në shuma të ndryshme. Të gjithë dëshmitarët kanë pohuar pa hezitim edhe arsyen përse kanë pranuar të tërheqin paratë dhe atë, për shkak se ishin shoqëruar me të akuzuarit e caktuar, apo kishin ende raporte familjare, raporte fqinjësie apo miqësie, apo edhe për interes të tyre ngase u ishte premtuar ndonjë “çarrosje” qoftë me drekë apo kafe, apo me pagesë në shumë simbolike prej 15, 20 apo 30 euro për një tërheqje. Mirëpo e përbashkëta e deklaramit të të gjithë dëshmitarëve është se, të njëjtit paratë i kishin tërhequr dhe aty për aty ua kishin dhënë secili të akuzuarit të caktuar sipas marrveshjes dhe faktin e tërheqjes së parave nuk e kishin parë fare si diçka të ndaluar meqë me Letërnjoftim të vet i kishin tërhequr paratë dhe i kishin dorëzuar menjëherë. Disa nga të akuzuarit ishin interesuar për arsyen e tërheqjes, u ishin dhënë disa arsye të thjeshta aq sa edhe banale nga të akuzuarit përkatës, disa dëshmitar ishin interesuar se nga vijnë paratë, u ishte thënë se janë nga gruaja, apo familjarët tjerë të t’akuzuarit të caktuar dhe dëshmitarët kanë besuar, disa nuk kishin pyetur fare ngase nuk u kishte interesuar, por asnjëri nuk e mohonte faktin e tërheqjes së parave nga këto dy institucione financiare por, pa i mbajtur mend saktë shumat e tërhequra ngase kishte kaluar kohë e gjatë siç thonin mbi dhjetë vjet. Kësisoj gjithë dëshmitarët kishin deklaruar edhe në polici dhe secili mbetej pranë deklaramive të dhëna, pa ndonjë tentativë prë të bërë çfarëdo devijimi.

Dëshmitarët F.K.,<sup>8</sup> B.G, A.Sh e A.Z.,<sup>9</sup> F.Sh., N.B e S.L.,<sup>10</sup> kanë deklaruar se kanë tërhequr para për të akuzuarin A., dëshmitarët Xh.G., dhe Y.J., kanë tërhequr para për të akuzuarin V.M, dëshmitarët B.P., F.B., M.B., S.S, Sh.A., e A.Th kanë tërhequr para për të akuzuarin A.A., ndërsa dëshmitari E.Z deklaron se ka tërhequr para për personin e panjohur siç e kishte identifikuar si “turku”, të cilin e përshkruan si “*zeshkan, me një mjekërr, diku 1.70 i gjatë, më i shkurtë se unë, mosha diku kah 28-29 vjet, pak i plotë me bark, ka fol turqisht dhe një shqipe të rëndë*”, të njëjtin e ka takuar në Prishtinë tek “Llesna” dhe e ka pyetur nëse mund të tërheq para për të dhe se i njëjti e ka shpërblyer për çdo tërheqje me nga 50 e deri në 100 euro.

<sup>7</sup> Shih proqesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.10.2022, tek pyetja e prokurorit në fq.6

<sup>8</sup> Shih proqesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 29.09.2022

<sup>9</sup> Shih proqesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 07.10.2022

<sup>10</sup> Shih proqesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.10.202

### **3. Mbrojtja e të akuzuarve**

**3.1. I akuzuari A.B.**, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 22.11.2022 ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij ka vendosur të shfrytëzojë të drejtën për t'u mbrojtur në heshtje, ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë paraprakisht në polici me datë 09.01.2020 dhe nuk ka cfarë të shtoj më tepër.

*I akuzuari A.B., në deklaratën e dhënë në Polici me datë 09.01.2020 pa praninë e mbrojtësit ka pranuar tërheqjen e parave nga Republika Doemnikane dhe Turqia përmes WU dhe MG gjatë viteve 2013 dhe 2014 dhe atë me qëllim që t'ia jep personit me emrin Mahmut për të cilin thotë se ishte turk dhe se e kishte takuar në "Casino Bondi" në lagjen Ulpiana në Prishtinë dhe, i cili i kishte thënë se merret me biznes me peshqi në Turqi, ndërsa në Kosovë i duhen për ndërtim, i njëjti i kishte premtuar se për çdo tërheqje do t'ia jep atij nga 20-30 euro andaj edhe kishte pranuar të bëjë tërheqje parash në shuma prej 3000- 5000 euro. I akuzuari poashtu pohon se u kishte thënë disa personave të tjerë të njohur të tërheqin para për të dhe atyre poashtu u kishte dhënë nga 10-15 euro për çdo tërheqje, të gjitha paratë ia kishin dhënë turkut me emrin Mahmut. Në fund pohon se ka qenë në gjendje të dobët ekonomike por nuk e ka dijtur se tërheqja e parave është e kundërligjshme.*

**3.2. I akuzuari V.M.**, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 14.12.2022 ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij ka vendosur të shfrytëzojë të drejtën për t'u mbrojtur në heshtje, ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë paraprakisht në polici me datë 08.01.2020 dhe 05.03.2021, nuk ka cfarë të shtoj më tepër.

*I akuzuari V.M., në deklaratën e dhënë në Polici me datë 08.01.2020 pa prani të mbrojtësit ka deklaruar se, poashtu gjatë vitit 2015 përveç nga familjarët nga jashtë Kosove, ka pranuar para edhe nga Republika Domenikane për një turk të cilin e thirnin "Abej" me të cilin e ka njoftuar një person I.B., që tani veç ka ndërruar jetë, poashtu e përshkruan turkun si "diku rreth 40 vjeçar, i gjatë, i plotë mesatar, zeshkan, sy kaltër" thotë se e ka folur edhe shqipen, janë takuar shpesh në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, ka tërhequr para në WU dhe MG për të dhe, për çdo tërheqje turku ia ka dhënë 30-50 euro, pohon se disa personave poashtu u ka thënë për të tërhequr para për të, iu ka treguar se ia jep 30-50 euro, ndërsa të akuzuarit në këtë çështje penale nuk i njef, ndërsa për veten thotë se në vitin 2015 ka shkuar në Gjermani.*

**3.3. I akuzuari A.A.**, në shqyrtimin gjyqësor me datë 14.12.2022 ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij ka vendosur të shfrytëzojë të drejtën për t'u



mbrojtur në heshtje, ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë paraprakisht në polici me datë 10.03.20220 dhe nuk ka cfarë të shtoj më tepër.

*I akuzuari A.A., në deklaratën e dhënë në Polici me datë 10.03.2020* pa prani të mbrojtësit, ka deklaruar se ka tërhequr 2-3 herë para në WU në emër të personit të cilin e quan “turku”, i cili i kishte premtuar se do t’ia jep nga 20-30 euro, por emrin nuk ia dinte vetëm se e përshkruan si “rreth 53 vjeçar, 175 i gjatë, pak i shëndosh, zeshkan, flokë të thinjura”, kishin komunikuar në shqip dhe se për herë të fundit e kishte parë në vitin 2014. E pohon se gjatë vitit 2013-2014 i kishte kërkuar edhe 3-4 personave të tjerë kryesisht fqinjë, për të tërhequr paratë e dërguara nga Turqia dhe Republika Domenikane të cilëve poashtu u kishte dhënë nga 20-30 euro, në fund të gjitha paratë i janë dhënë turkut, dhe se për këtë veprim nuk ka qenë në dijeni se është ndonjë rrezik apo se paraqet shkelje ligjore.

**3.4. I akuzuari A.T.,** në shqyrtimin gjyqësor me datë 14.12.2022 ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij ka vendosur të paraqes mbrojtjen e tij me deklaram, derisa në polici është mbrojtur në heshtje. I njëjti gjatë deklaramit fillimisht mohon t’a ketë njohur të akuzuarin V., thekson se tërheqjen e parave nga WU dhe MG gjatë viteve 2013-2014 e ka bërë për A., B., meqë A.,i i ka kërkuar këtë shërbim pasiqë i kishte thënë se “nuk ka letërnjoftim”, andaj ka pranuar të tërheq paratë dhe atë afër 10-15 herë ka tërhequr pa asnjë shpërblim ngase A.,in apo siç e ka njohur me pseudonimin “Daqki” e ka pas shok të fëmijërisë që prej 42 vitesh dhe ende kanë shoqëri, nuk është interesuar për arsyen përse i duhen dhe nga kush i vijnë paratë, meqë ka jetuar afër 20 vite jashtë Kosovës dhe siç thotë këtë fakt e ka konsideruar si çështje të tij private. Më pas pohon ti ketë thënë edhe disa të tjerëve të tërheqin para sërish për me ia dhanë A.,it, nuk ka dyshuar asgjë, paratë kanë ardhë siç thotë në mënyrë legale dhe janë tërhequr me letërnjoftim, i është dhënë dëshmia e parave të tërhequra, nuk i ka tërhequr me dhunë, me mashtrim apo duke e tortuaruar dikend, thekson se është interesuar nëse ka ndonjë rrezik apo jo dhe, i është thënë se nën shumën 10.000 euro ska arsye as me u frikësu, dhe në fund thotë se nuk e din shumën e saktë të mjeteve të tërhequra. Në vazhdim deklaron se në atë kohë vet ka punu si shef - kuzhinier në një restaurant “Gegë” përballë Filhamonisë, dhe se poashtu edhe katër persona të tjerë i ka angazhuar për me tërheq para pasi që vet e kishte humbur letërnjoftimin në Mal të Zi dhe këtë e ka bërë veq për favor për A.,in. Në fund sqaron se gjatë viteve 2017-2018 kur e ka thirrë polica për këtë çështje vetëm si dëshmitar, A.,i kishte shkuar në Gjermani, pastaj ky vet ishte burgosur nga viti 2019 për një veper tjetër penale dhe nuk ishin parë më me A.,in deri më tani në gjykatë.

#### 4. Fjala Përfundimtare e palëve

Të gjitha palët kanë prezantuar fjalët e tyre përfundimtare qoftë në formë të shkruar duke i elaboruar të njëjtat<sup>11</sup> qoftë edhe gojarisht, ndërsa pas rihapjes së procedurës gjyqësore<sup>12</sup> dhe kthimit në fazë të procedurës së provave, sërish disa nga mbrojtësit kanë mbetur pranë fjalëve përfundimtare të parashtruara më parë e disa kanë shtuar ashtu siç precizohet më poshtë.

**4.1. Prokurori nga Prokuroria Speciale në fjalën përfundimtare deklaron se,** ekspertiza financiare vërteton në tërësi gjendjen faktike si në aktakuzë, qëndron në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar me 16.12.2022.

*Prokurori në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka potencuar se, në këtë çështje penale në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të kësaj aktakuze, se në veprimet e të akuzuarve manifestohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar. Këtë gjendje faktike e vërtetojnë edhe dëshmitë e dëshmitarëve të cilët janë dëgjuar në shqyrtim gjyqësor, si dëshmi më të fuqishme paraqet Raporti informues me nr të referencës 2020-KE-82 i dt.29.1.2020 i lëshuar nga Policia e Kosovës – DHKEK – NJHPP – Prishtinë, më çka vërtetohet lëvizja e parave. Për më tepër kjo vërtetohet edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna në polici dhe në shqyrtim gjyqësor të cilët shprehimisht përmendin emrat e të akuzuarve me kërkesë të të cilëve kanë tërhequr mjete financiare, deklaratat e të cilëve janë në përputhje me njëra tjetrën. Ka shtuar se në pajtim me ligjin e Kosovës është e mjaftueshme që kryerësi i veprës e di apo ka arsye për ta ditur se “prona në fakt është e ardhur nga krimi”. Nuk është e nevojshme që kryerësi i veprës ta dijë apo dyshoj se cila është vepra e saktë e pre-supozuar apo rrugën kriminale nga e cila rrjedh pasuria. Ngjashëm, nuk është e nevojshme që prokuroria t’i ofroj këto lloje të provave, vetëm kërkohet që prona në fakt të jetë rezultat i “ndonjë forme të aktivitetit kriminal”. Ky përkufizim është marrë nga neni 9 (6) i Konventës së KiE që parasheh se që një dënim për shpërlarje të parave është i mundur kur provohet që prona “ka prejardhje nga një vepër e pre-supozuar pa qenë nevoja të thuhet saktësisht secila vepër”. Ka shtuar se nuk ishte fare bindëse mbrojtja e të pandehurve se tërheqja e mjeteve është bërë për të ndihmuar dikujt tjetër, madje fare nuk ishte bindëse mbrojtja e të pandehurve se në mungesë të dokumenteve të identifikimit kanë tërhequr mjete për persona tjerë. Kjo, ngase dihet, është fakt notor se dokument i identifikimit është pasaporta,*

<sup>11</sup> Shih proqesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 16.12.2022 –para rihapjes së procedurës

<sup>12</sup> Shih proqesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.04.2023 –pas rihapjes së procedurës

letërnjoftimi, patent shoferi etj, kështu në mungesë të një dokumenti, mjetet mund të tërhiqen edhe më dokument tjetër si dhe tërheqja e mjeteve për një periudhë të gjatë aq më tepër e vërteton bindshëm se nuk ishte fare në pyetje mungesa e dokumentit identifikues apo tërheqja për t'i kryer shërbim dikujt tjetër, por qëllimi i për Fe ve të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme me anë të shpërlarjes së parave, andaj gjykata nuk duhet t'ia falë besimin mbrojtjes të dhënë nga ana e të akuzuarve, sepse mbrojtja e tyre është në kundërshtim të thellë me raportet hetimore e po ashtu nga vet mbrojtja e tyre e dhënë në gjykatë, në fund i propozon gjykatës që të akuzuarit A.B., V.M., A.A., dhe A.T., të shpallen fajtor për veprën penale për të cilën akuzohen, të njëjtit të dënohen sipas ligjit duke marrë parasysht rrethanat rënduese, ndaj tyre të shqiptohet një dënim që përkon me veprën penale për të cilën akuzohen, si dhe të njëjtit të ngarkohen me pagesën e shpenzimeve të procedurës penale.

**4.2. Mbrojtësi i të akuzuarit A.B., Av.Florent Latifaj në fjalën përfundimtare** deklaron se, qëndron pranë fjalës përfundimtare të prezantuar me datë 16.12.2022, potencon faktin se nuk janë përmbushur elementet e veprës penale të shpërlarjes së parave sepse nuk ka burim të jashtëligjshëm të mjeteve monetare, në faqen e 9 të aktakuzës por edhe nga raporti i ILEC-ut shihet se personat të cilët kanë dërguar para nuk kanë të kaluar kriminale dhe as proces gjyqësor kundër tyre, cka medoemos tregon se nuk bëhet fjalë për para të pista që kanë nevojë me u shpërlla. Çështje tjetër është fakti se, çfarë ka bërë i mbrojturi i tij dhe të akuzuarit tjerë më shumë sesa dëshmitarët që janë dëgju në këtë çështje penale, të gjithë vetëm kanë tërhequr para prej dikujt tjetër, e si mund të amnistohen 25 persona e vetëm katër të akuzohen, këtu prokuroria nuk ka bërë trajtim të barabartë të palëve dhe kjo është drejtësi selektive, këto veprime thekson se janë marrë në vitin 2013 dhe nga atëherë e as më parë i mbrojturi i tij asnjëherë nuk ka kryer veprë tjetër penale. Ndërsa sa i përket ekspertizës, sipas mbrojtësit e njëjta nuk korrespondon me kohën e precizuar në dispozitiv të aktakuzës, në fund propozon gjykatës që A., B ta shpall të pafajshëm sepse nuk është kryes i kësaj veprë penale.

*Mbrojtësi në fjalën përfundimtare të prezantuar me datë 16.12.2022*, ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar me asnjë provë se i mbrojturi i tij A.B., të ketë kryer veprën penale të Shpërlarjes së parave. Kjo për faktin se i mbrojturi i tij në asnjë moment nuk ka pohuar e as mohuar se ka tërhequr një shumë të caktuar të parave nga WU dhe MG, por edhe sikur të thoshte se i ka tërhequr vet, shtrohet pyetja a janë konsumu elementet e veprës penale të Shpërlarjes së parave dhe nëse i referohemi përgjigjes së autoriteteve respektive Turke dhe Domenikane të cilën e ka kërkuar PSRK-ja nëpërmjet ILEC-ut mund të vijmë në përfundim se paratë e transferuara nëpërmjet këtyre institucioneve mikrofinanciare nuk rrjedhin nga asnjë veprimtari ilegale. Këtë e ka thënë edhe Gjykata e Apelit në vendimin e saj të datës 27 Janar

2022, në faqe 5, paragrafi i fundit 4 rreshtat e fundit thuhet se: “... duke pas parasysh që vet prokurori në aktakuzë ka theksuar se personat të cilët kanë dërguar para nuk kanë të kaluar kriminale e as nuk kanë ndonjë proces tjetër në autoritetet respektive. Pra, nga cilat prova rrjedhë dyshimi i bazuar se paratë janë të aktiviteteve kriminale dhe nga cilat prova rrjedhë dijenia e të pandehurit”, tutje duke theksuar se këso lloj veprimtarie kur nuk deklarohen shumat mbi 10.000 euro e që nuk rrjedhin nga aktivitetet kriminale mund të konsiderohen si kundërvajtje doganore sepse për t’u konsumu vepra penale e Shpërlarjes së parave duhet që paratë të jenë të pista, dmth burimin të kenë nga një aktivitet kriminal, ndërsa në këtë rast paratë rrjedhin nga persona që nuk merren me aktivitet kriminal. Personat që pranojnë paratë të akuzohen për Shpërlarje të parave nuk ka jo vetëm qëndrueshmëri juridike, por s’ka as lidhje logjike të shëndoshë, sepse tingëllon sikur paratë që i ka dërgu dikush kanë qenë të pastra e kur dikush i ka tërhequr janë bërë të papastërta, ndërsa vet tërheqja e mjeteve nuk është vepër penale. Tutje thekson se i mbrojturi i tij ka punu taksist, tani punon në autoparking ndërsa ata që merren me shpërlarje parash kanë nivel më të lartë të jetesës, andaj lut gjykatën që të mbrojturin e tij ta lirojë nga akuza.

*I akuzuari A.B., në fjalën përfundimtare e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, shton se fillimisht në WU ka pyetur se a janë paratë të pista, i kanë thënë se jo, andaj edhe ka tërhequr derisa i është bllokuar llogaria, pastaj ka gjetur njerëz të tjerë të familjes, shokë dhe nuk ka qenë në dijeni që ka diqka të keqe.*

**4.3. Mbrojtësja e të akuzuarit V.M., Av. Teuta Zhinipotoku në fjalën përfundimtare** deklaron se, qëndron pranë fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datë 16.12.2022, shton se nuk janë përmbushur elementet e veprës penale të shpërlarjes së parave sepse edhe vet Gjykata e Apelit ka konstatuar se paratë e tërhequra nuk burojnë nga ndonjë veprimtari kriminale dhe shtrohet pyetja se, meqenëse eksperti e ka bërë edhe një plotësim apo rekapitulacion për dëshmitarët të cilët kanë tërhequr para dhe të cilët kanë qenë prezent gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor si të propozuar nga ana e PSRK, si mundën të njëjtit në këtë procedurë të jenë dëshmitarë, ndërsa i mbrojturi i saj të jetë i akuzuar, ku disa nga shumat e tërhequra nga ana e dëshmitarëve janë përafërsisht të njëjta me shumat e tërhequra nga tani të akuzuarit, andaj propozon gjykatës pas administrimit të të gjitha provave të mbrojturin e saj t’u lirojë nga akuza. *Mbrojtësja në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datë 16.12.2022 ka theksuar se, aktakuza është ngritur duke u nisur nga rrethanat gjenerale se kinse i mbrojturi i saj ka kryer veprime inkriminuese, derisa të gjitha veprimet të cilat i mveshen, i njëjti i ka ndërmarrë nga pavetëdija, nuk e ka ditur se veprimet e kryera janë të ndaluara dhe se mund të shkaktohet pasoja e ndaluar e cila është e sanksionuar, e të cilat sipas rrethanave objektive nuk ka qenë i obliguar*

t'i njeh, ndërsa sipas aftësive të tij nuk ka mundur as t'i parashikoj, sepse, i njëjti ka qenë përdorues i drogës ku ka qenë i hospitalizuar në spitalin e Neuropsikiatrisë. Me nenin 26 par.1 të KPRK përcaktohet se “personi i cili për shkaqe të arsyeshme nuk e ka ditur ose nuk ka mundur të dijë se vepra është e ndaluar nuk është penalisht përgjegjës”. Ka shtuar se Prokuroria ka dështuar të vërtetoj se paratë rrjedhin nga aktiviteti kriminal, ku pas kthimit të përgjigjes së Republikës Dominikane ku Policia e Kosovës ka parashtruar kërkesë pranë Interpol-it vërtetohet se, i mbrojturi i saj nuk ka asnjë të kaluar kriminale dhe nuk është pjesë e ndonjë procesi tjetër pranë autoriteteve të këtij shteti. Më tej në fjalën përfundimtare mbrojtësja ka theksuar se i mbrojturi i saj ka kryer veprimet e njëjta sikurse edhe dëshmitarët tjerë të cilët janë pjesë e kësaj procedure mirëpo i mbrojturi i saj është i vetmi ndaj të cilit është ngritur aktakuzë pa u vërtetuar më asnjë provë bindëse dhe konkrete gjendja faktike, në veprimet e tij nuk janë realizuar elementet e përgjithshme dhe tiparet e posaçme që e përbëjnë figurën e veprës penale të shpërlarjes së parave, andaj propozon gjykatës që në mungesë të provave t'a lirojë nga akuza.

*I akuzuari V.M., në fjalën përfundimtare e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtëses dhe nuk shton asgjë më shumë.*

**4.4. Mbrojtësi i të akuzuarit A.A., Av.Behar Ejupi në fjalën përfundimtare** të prezantuar pas rihapjes së procedurës deklaroi se, me provat e prezantuara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në mënyrë të qartë, të plotë e bindëse nuk është arritur të përmbushet kushti ligjor që përtej çdo dyshimi të bazuar të dëshmohet se i mbrojturi i tij A.A., ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar sipas pikës II të dispozitivit të aktakuzës për të cilën veprë ka vazhduar gjykimi edhe pas pushimit të procedurës për pikën I sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.S.nr.2/2022 dhe atë, me provat e njëjta që kanë qenë të propozuara në fillim të ngritjes së aktakuzës, që dmth se nuk është veçuar asnjë provë e cila ka pasur të bëjë për dispozitivin e I të aktakuzës dhe, si rezultat i kësaj mbrojtje ka propozuar që si prova materiale të nxirren dhe administrohen fletëtërheqjet të cilat janë në pikat ku janë tërhequr mjetet. Në vazhdim mbrojtësi ka theksuar se janë dëgjuar shumë dëshmitar që kanë dhënë deklarata në mesin e tyre ka pasur të tillë që kanë deklaruar se kanë pranuar para për shërbimin e tërheqjes së parave në WU, që dmth se veprimet e të mbrojturit të tij dhe veprimet e dëshmitarëve janë të njëjta, në fund i propozon gjykatës të nxjerrë aktgjykim lirues për faktin se nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale sipas pikës II të dispozitivit të aktakuzës.

*Mbrojtësi në fjalën përfundimtare të prezantuar me datë 16.12.2022 ka deklaruar se, duhet të kihet parasysh dy prova të administruara si ekspertiza financiare dhe rekapitulacioni mbi shumat e tërhequra të mjeteve nga personat-dëshmitarët për periudhën 31.12.2013 - 31.12.2014 nga shteti i Turqisë dhe Republika Domenikane, me të cilat vërtetohet se vlerat e mjeteve të tërhequra*

sa i përket të mbrojturit të tij ndryshojnë nga provat e administruara, ndërsa sipas asaj çfarë ka shënuar eksperti financiar në ekspertizë, përkatësisht në faqe 3 se secili dëshmitar ka pranuar mjete të nënshkruara në emër të vetin për mjete që i kanë ardhë në emër të vet dhe në adresë të vet e jo në emër të të pandehurve. Ky sipas mbrojtjes është argument i qartë që vërteton se nuk ka asnjë dallim në veprime nga të akuzuarit dhe dëshmitarët, ndërsa sipas ekspertit nuk ka asnjë autorizim me shkrim nga të pandehurit që i kanë autorizuar dëshmitarët për tërheqjen e mjeteve nga këto insitucione financiare, andaj e konteston mënyrën se si prokuroria ia falë besimin dëshmitarëve të cilët janë dëgjuar dhe të njëjtit kanë deklaruar se për këto shërbime ka pas rast kur kanë pranuar edhe mjete financiare në shuma të ndryshme. Mbrojtësi potencoi edhe kohën e kryerjes së veprës penale të cilën prokuroria është e detyruar t'a potencojë në aktakuzë, ku është e shënuar “në periudhën kohore nga viti 2013 – 2014” që për mbrojtjen nënkupton kohën “deri më 1 Janar 2014” e jo 31 Dhjetor 2014 siç është shënuar në ekspertizë, sepse për këtë periudhë siç potencon mbrojtja i mbrojturi i tij nuk është i akuzuar. Në fund i propozon gjykatës që për të mbrojturin e tij A.A., të nxjerr aktgjykim lirues.

*I akuzuari A.A., në fjalën përfundimtare* deklaroi se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

**4.5. Mbrojtësja e të akuzuarit A.T., Av.Sahadete Gashi në fjalën përfundimtare** deklaroi se, mbetet pranë fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datë 16.12.2022 duke i propozuar gjykatës që të mbrojturin e saj t'a lirojë nga akuza.

*Mbrojtësja në fjalën përfundimtare të dorëzuar më shkrim me datë 16.12.2022* ka theksuar se, prokuroria gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka arritur ta argumentojë me prova konkrete se i mbrojturi i saj ka kryer veprën penale që i vihet në barrë. Ka shtuar se përshkrimi dhe cilësimi i veprës penale është shumë i mangët, faktet e prezantuara në aktakuzë nuk kanë paraqitur në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht, nuk vërtetojnë se i mbrojturi i saj të ketë ndërmarrë çfarëdo veprimi inkriminues. Sa i përket veprës penale të Shpërlarjes së parave mbrojtja konsideron se i mbrojturi i saj asnjëherë nuk ka qenë në dijeni se është duke kryer apo ka kryer këtë vepër penale sepse paratë në shumën totale 95,189.86 Euro asnjëherë nuk i ka pranuar në emër të tij dhe për llogarinë e tij dhe ky fakt nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme në këtë aktakuzë. Ka shtuar se, i mbrojturi i saj ka mundur të jetë vetëm në cilësinë e dëshmitarit sikur edhe dëshmitarët në këtë procedurë penale, sikur që fillimisht është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit dhe jo të trajtohet si i pandehur, prokuroria ka dështuar të provoj faktin se i mbrojturi i saj ka marrë ndonjë shpërblim për punën e kryer, andaj në bazë të gjendjes të këtyre faktike, mbrojtja konsideron se prokuroria nuk ka arritur në mënyrë të sigurt dhe të

pakontestueshme të argumentoj fajësin e të mbrojturit të saj dhe i propozon gjykatës që të njëjtin t'a lirojë nga akuza.

*I akuzuari A.T., në fjalën përfundimtare deklaron se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtëses dhe nuk ka çfarë të shtoj më tepër.*

#### **5. Provat materiale të paraqitura në shqyrtim gjyqësor**

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor administroi provat materiale si më poshtë:

- Email-i "ILECU", nr.reference: ILECU-1282-17-23 i datës 23.07.2018 i lëshuar nga Policia e Kosovës, ILECU;
- Raporti Informues Administrata Tatimore e Kosovës me nr.reference 149/2021 i datës 21.04.2021 i lëshuar nga Policia e Kosovës – DHKEK-NJHPP-Prishtinë;
- Raporti Informues mbi zbulimin e të dhënave financiare me nr.reference 2020-KE-82 i datës 29.01.2020 i lëshuar nga Policia e Kosovës – DHKEK-NJHPP-Prishtinë;
- Raporti informues mbi zbatimin e autorizimit – deklaratat e të pandehurve me nr.reference DHKEK-P-81/18 i datës 26.03.2021 të lëshuar nga Policia e Kosovës – DHKEK-NJHPP-Prishtinë;

*Pas rihapjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 18.04.2023 janë administruar edhe provat si më poshtë:*

- Ekspertiza financiare e hartuar nga ekspertit-financiar Ramadan Ferizi e datës 20 Janar 2023;
- Shtesa -Rekapitulacioni në tri faqe i ekspertit-financiar Ramadan Ferizi e dorëzuar në gjykatë 28 Mars 2023.

Pas rihapjes së shqyrtimit gjyqësor dhe kthimit në procedurë të provave, palët nuk patën ndonjë vërejtje në provat e administruara, as propozime të tjera për plotësimin e procedurës së provave, të akuzuarit nuk paten asgjë për të paraqitur apo për të shtuar në mbrojtjen e tyre.

#### **6. Vlerësimi i përgjithshëm i provave të administruara në shqyrtim gjyqësor dhe analiza e tyre në raport me gjendjen faktike të vërtetuar - Gjetjet e gjykatës**

Pasi që gjykata bëri administrimin e provave të paraqitura në shqyrtim gjyqësor, të njëjtat i analizoi dhe vlerësoi me kujdes e me ndërgjegje, secilën veç e veç dhe në ndërlidhje reciproke me njëra tjetrën në kuptim të dispozitës së nenit 359 të KPP, vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që katër të akuzuarit i liroi nga akuza sa i përket vepërs penale të shpërlarjes së parave të precizuar për secilin në pikën II të dispozitivit të aktakuzës.

***Faktet e pa kontestuara*** - Nga provat e administruara të lartshënuara, gjykata vërtetoi si të pa kontestuar faktin se të akuzuarit kishin realizuar tërheqje parash në shuma të ndryshme nga persona të panjohur nga Turqia dhe Republika Domenikane gjatë periudhës së precizuar si në aktakuzë.

Gjithashtu nuk ishte kontestues fakti se të akuzuarit edhe përmes personave të tjerë kishin realizuar tërheqje parash, akush nuk e kontestoi angazhimin qoftë të mikut, apo kolegut, fqijt madje edhe të familjarit për tërheqjen e parave nga institucionet financiare WU dhe MG.

***Faktet e kontestuara*** – Si fakt i kontestuar kryesor por jo i vetëm që konsiston në qëndrueshmërinë e veprës penale të shpërlarjes së parave, ishte prejardhja apo burimi i parave, dijenia e të akuzuarve për prejardhjen e parave, përkatësisht për kundërligjshmërinë e Fit të atyre parave dhe qëllimin e dërgesës së atyre parave.

Në vazhdim të aktgjykimit, gjykata jep vlerësime të qarta lidhur me arsyet për çfarë i konsideron provat e lartshënuara dhe faktet nga ato prova të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe jep shpjegime për arsyet në të cilat është bazuar në nxjerrjen e konstatimit se, nuk është provuar se tani të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

### **6.1 Vlerësimi i dëshmimeve**

Nga dëshmitë e dëshmitarëve gjykata vetëm sa konfirmoi konstatimet e dhëna në aktakuzë për realizimin e tërheqjeve të parave nga WU dhe MG për të akuzuarit e apostrofuar të cilët i njifnin më parë dhe nga të cilët disa kishin realizuar ndonjë përf të vogël material. Andaj gjykata nuk pati ndonjë arsye të mos ua fal besimin, konsideroi shumë e natyrshme që shifrat të mos i mbanin në mend posaçërisht kur bëhet fjalë për një kohë bukur të mëhershme, por e rëndësishme është se tërheqjet që i kishin realizuar ishin lehtësisht të vërtetuara nga deklaratimet e të akuzuarve por



edhe me prova tjera materiale si, me raporte informuese të policisë apo edhe me ekspertizë financiare.

Mirëpo nga dëshmitë e dëshmitarëve gjykata nuk arriti të vërtetojë ndonjë veprim të paligjshëm të t'akuzuarve, apo ndonjë fakt relevant që ka të bëjë me elementet e veprës penale të shpërlarjes së parave.

*Nga mbrojtja e të akuzuarve* gjykata vërtetoi poashtu realizimin e tërheqjeve të parave të precizuara si në aktakuzë, përkatësisht në ekspertizë, por jo edhe dijeninë e të njëjtëve për rrjedhën, përkatësisht për burimin e parave. Duke pas parasysh se të njëjtit kanë tërhequr para nga persona të panjohur vërtetë është e logjikshme të kenë patur një qëllim, në mungesë të çfarëdo prove të drejtpërdrejtë apo rrethore që do të vërtetonte burimin e parave dhe qëllimin e dërgesës së parave tek të akuzuarit, gjykata duhet të besojë në pohimet e të akuzuarve se të njëjtit nga çdo tërheqje parash për personoin e tretë kishin realizuar përfe personale vërtetë në shuma të vogla. Pra, ky arsyetim jepet edhe bazuar në faktin se, provat e ofruara materiale nuk kanë dëshmuar se të njëjtit i kanë deponuar paratë në llogaritë e tyre bankare apo, ato para i kanë konvertuar në pasuri qoftë të tundshme apo të patundshme me qëllim të fshehjes apo maskimit të burimit të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Çfarëdo shpjegimi ndryshe gjykata do t'a kishte besuar sikur të mos kishte prova materiale që vërtetojnë të kundërtën e pretendimit të prokurorisë, e siguruar përmes bashkëpunimit ndërkombëtar nga ILECU sipas së cilit bashkëpunim, nga shteti i Republikës Domenikane është siguruar përgjigja se personat të cilët kanë dërguar para nga ky shtet nuk kanë të kaluar kriminale e as nuk kanë ndonjë proces tjetër në autoritetet respektive. Ndërsa për shkak të mos përgjigjes nga shteti i Turqisë, gjykata absolutisht nuk mund të mbetet me supozimin se paratë e dërguara nga ky shtet kanë burimin e paligjshëm.

## **6.2. Vlerësimi i provave materiale**

*Nga prova materiale - E-mail "ILECU" me nr.ref.1282-17-23 e datës 23.07.2018*, vërtetohet se Policia e Kosovës – DHKEK-DPP përmes bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit, ka parashtruar Kërkesë në Interpol që të sigurohen informacione lidhur me transaksionet e dyshuara për personat e cekur nga Republika Domenikane dhe ajo e Turqisë dhe, kërkesës së autoriteteve policore të Republikës së Kosovës i është përgjigjur vetëm Republika Domenikane me konstatimin se personat e cekur në kërkesë nuk kanë të kaluar kriminale e as ndonjë proces

tjetër në autoritetet respektive. Gjykata rithekson se, kjo provë nuk e mbështet akuzën që i vihet në barrë të akuzuarve.

***Nga prova materiale - Raporti Informues i Administratës Tatimore të Kosovës (tutje ATK) me nr.reference 149/2021 i datës 21.04.2021,*** vërtetohet se Prokuroria me datë 19.04.2021 ka kërkuar nga ATK informata lidhur me obligimet tatimore të ndonjë biznesi për të akuzuarit, ndërsa ATK lidhur me të dhënat e kërkuara për të akuzuarit për periudhën 2012-2015, përmes insitucioneve financiare WU dhe MG, ka rezultuar se të akuzuarit kanë pranuar para nga Republika Domeikane, Turqia dhe Bullgaria në emër të tyre dhe për perosna të tjerë dhe për këtë shërbim kanë dhënë shpërblim prej 20 dei në 50 euro mirëpo sipas përgjigjes së ATK “*vlerësimi tatimor lidhur me shumat e parave mund të bëhet vetëm për gjashtë muaj*”. Andaj edhe nga kjo provë gjykata nuk vërteton ndonjë fakt të ri, rrjedhimisht asnjë element të veprës penale që i vihet në barrë të akuzuarve.

***Nga prova materiale - Raporti Informues mbi zbulimin e të dhënave financiare për të akuzuarit, me nr.reference 2020-KE-82 i datës 29.01.2020*** i lëshuar nga Policia e Kosovës – DHKEK-NJHPP-Prishtinë, rezulton se sipas informatave të RBKO i akuzuari A.B., nuk ka të dhëna të realizuara, i akuzuari V.M nuk posedon llogari bankare ndërsa ka realizuar disa tërheqje nga WU nga Republika Domenikane, i akuzuari A.A., ka poseduar llogari por të njëjtën e ka mbyllur në vitin 2013, ndërsa ka realizuar disa transaksione në WU nga Turqia dhe Bullgaria, i akuzuari A.T., ka realizuar transaksion një herë në WU nga Turqia. Ndërsa sipas informatave nga MG i akuzuari A.B., ka pranuar para 51 herë, në shumë totale 180,469 euro, ndërsa ka dërguar para një herë në shumë prej 109 euro, i akuzuari V.M ka pranuar një herë para në shumë prej 64.813 euro ndërsa ka dërguar para një herë në shumë prej 528 euro, i akuzuari A.A., ka pranuar para në shumë totale prej 18,998 euro dhe i akuzuari A.T., ka pranuar para dhjetë herë në shumë totale prej 8.476 euro ndërsa ka dërguar para një herë në shumë prej 424 euro. Nga kjo provë gjykata vetëm sa vërteton faktin tanimë të pakontestuar se të akuzuarit kanë pranuar para në këto dy institucione financiare WU dhe MG, mirëpo raporti përfshinë periudhë më të gjatë se sa të akuzuarit ngarkohen në aktakuzë. Derisa sipas përshkrimit në aktakuzë vetëm dy të akuzuarit A.B., dhe V.M kanë tërhequr para personalisht si dhe kanë angazhuar persona të tjerë, ndërsa dy të akuzuarit A.A., dhe A.T., vetëm kanë angazhuar persona të tjerë për tërheqjen e parave nga Republika Domenikane dhe ajo e Turqisë dhe atë, për periudhën kohore siç precizohet nga vitit 2013-2014.

***Nga Raporti informues mbi zbatimin e autorizimit – deklaratat e të pandehurve me nr.reference DHKEK-P-81/18 i datës 26.03.2021*** të lëshuar nga Policia e Kosovës – DHKEK-NJHPP-Prishtinë, gjykata vërteton se tre të akuzuarit ishin dëgjuar në polici me autorizim të prokurorit pa prani të mbrojtësit, kishin deklaruar se paratë i kishin tërhequr për personin të cilin e përshkruanin si “turku” me të cilin merreshin vesh në gjuhën shqipe dhe i cili u kishte premtuar një shumë të parave për tëreqje, ndërsa i akuzuari A.T., kishte shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje. Kjo provë vetëm se vërteton deklaratimet e të akuzuarve.

***Nga Ekspertiza financiare e hartuar nga eksperti-financiar Ramadan Ferizi e datës 20 Janar 2023***; gjykata vërtetoi faktin se të akuzuarit kishin realizuar tërheqje parash në shuma të precizuara si në ekspertizë nga institucionet financiare WU dhe MG gjatë periudhës përfshirë vitin 2013 dhe 2014, e poashtu ekspertiza vërtetoi shumat e sakta të tërhequra nga secili person i precizuar me emër e mbiemër që është i përfshirë në aktakuzë si dëshmitar. Mirëpo ekspertiza nuk ofroi gjykatës ndonjë shënim më tepër për dërguesit e parave, psh ndonjë përshkrim tekstual të qëllimit të dërgesës së parave, kjo për faktin se sipas rregullave bankare në WU dhe MG nuk kërkohej asgjë më tepër përveç emrave të plotë të dërguesit dhe pranuesit të parave, të identifikuar me letërnjoftim, si dhe emërtimin e shteteve prej nga vijnë dhe ku tërhiqen paratë, përfshirë edhe datën e tërheqjes.

***Nga Shtesa -Rekapitulacioni*** në tri faqe i ekspertit-financiar Ramadan Ferizi e dorëzuar në gjykatë 28 Mars 2023, vërtetohet se qoftë të akuzuarit apo dëshmitarët kanë pranuar paratë në WU apo MG në emër të vetin dhe secili ka nënshkruar për paratë që i ka tërhequr, e që nuk kontestohet nga të akuzuarit, këta të fundit nuk u kanë dhënë ndonjë autorizim në formë të shkruar por vetëm kanë kërkuar nga dëshmitarët të tërheqin para në emër të tyre dhe dëshmitarët kanë pranuar qoftë për miqësi apo për interes përFi.

Nga provat materiale të lartshënuara gjykata nuk vërtetoi asgjë më tepër sesa aspektet e veprimeve të transaksioneve të realizuara nga të akuzuarit të cilët gjatë deklarimeve të tyre edhe i kishin pohuar.

## **7. Vlerësimi ligjor i veprës penale**

Me aktakuzë të PSRK katër të akuzuarit ngarkohen secili sipas pikës II të dispozitivit të aktakuzës - për veprë penale Shpërlarja e parave nga neni 302 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës lidhur me nenin 56 par.1, nënpar.1.1 të Ligjit nr.05/L-096 (në fuqi nga 15.06.2016) për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit, për të cilën

vepër penale parashihet dënueshmëria me burgim deri në dhjetë vjet dhe gjobë deri në tri herë më të madhe në vlerë të pasurisë që është subjekt i veprës penale.

Ndërsa ligji penal material 06/L-074 (*aktualisht në fuqi nga data 14.04.2019*) në nenin 302 i referohet Ligjit për shpërlarje parash si ligj special për kryesit e veprës penale të shpërlarjes së parave.

Vepra penale e shpërlarjes së parave nga neni 56 i Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit 05/L-096, në formën e saj themelore konsiderohet e kryer nga çdo kush i cili *“duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal”*.

Kryesi i akuzuar për shpërlarje parash mjafton të kryejë cilëndo nga veprimet e cituara në paragrafët e nenit 56, në rastin konkret sipas aktakuzës që është objekt i gjykimit, të akuzuarit ngarkohen sipas paragrafit 1.1. sipas të cilit kryesi *“konverton, transferon ose përpiqet të konvertoj ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë”*

#### **8. Gjetjet e gjykatës për lirimin e të akuzuarve nga akuza**

Gjykata vlerësoi dhe analizoi provat në shqyrtimin gjyqësor edhe atë një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 dhe 360 të KPP dhe erdhi në përfundim se nga këto prova nuk u vërtetua se tani të akuzuarit kanë kryer veprën penale ashtu siç ngarkohen me aktin akuzues.

Për t’u gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale të shpërlarjes së parave, fillimisht është e nevojshme të vërtetohet se pasuria buron nga ndonjë aktivitet kriminal, pra duhet medoemos që pasuria të jetë rrjedhojë e përFevë të ardhura nga aktiviteti kriminal dhe, autori të jetë në dijeni se pasuria që ai disponon është produkt i veprës penale apo aktivitetit kriminal dhe ai synon t’a pastrojë atë pasuri, duke i dhënë trajtën e një pasurie apo avantazhi ekonomik të ligjshëm. Pra, autori me qëllim të pastrimit të kësaj pasurie duhet të kryejë veprimin i cili përfshihet në njërën nga format e parashikuara në nenin 56 për shpërlarje të parasë.

Pra, në rastin konkret gjykata për të konstatuar se ekzistojnë elementet e veprës penale Shpëlarja e parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit 05/L-096, duhet të vërtetohet se ekzistojnë tri elemente: 1.Pasuria në këtë rast paratë duhet të vërtetohet se janë burim i veprës penale apo aktivitetit kriminal, 2. Paratë kanë qëllim të maskimit për nga mënyra e Fit, dhe 3. Pas maskimit duhet të rezultojnë në qëllim të përdorimit si burime të ligjshme.

Lidhur me elementin e parë të veprës penale, gjykata vlerësoi se nga provat ekzistuese të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është arritur të provohet se paratë burojnë nga ndonjë aktivitet kriminal e as të akuzuarit nuk kanë qenë në dijeni apo nuk kanë mund të dijnë se paratë burojnë nga aktiviteti kriminal, e ky është kriter bazik për ekzistimin e veprës penale të shpërlarjes së parasë.

Lidhur me elementin e parë se paratë burojnë nga ndonjë aktivitet kriminal gjykata vlerëson se, duke pas parasysh se paratë dërgohen nga shtetasit e huaj për persona të tjerë të panjohur në shtetin e Kosovës dhe, kjo mund të lë hapsirë për dyshime e supozime të ndryshme për përFe jo ligjore, mirëpo ky supozim jo që është vërtetuar si i tillë, por përkundrazi prokuroria me provën e siguruar nga Republika Domenikane ka vërtetuar se, dërguesit e parave nuk kanë ndonjë të kaluar kriminale apo proqes tjetër në autoritetet respektive, pra nuk është vazhduar me hetim të mëtejme për të vërtetuar rrjedhën e parasë, se në ç' mënyrë dërguesit kanë siguruar paratë dhe rrethanat tjera përse i dërgojnë paratë në shuma bukur të mëdha personave të panjohur në Kosovë dhe me çfarë destinimi. Ndërsa përgjigja e autoriteteve turke nuk figuron fare si pjesë e hetimit.

Lidhur faktin se të akuzuarit nuk kanë qenë në dijeni se paratë burojnë nga ndonjë aktivitet kriminal gjykata vlerëson se, të akuzuarit kanë dhënë shpjegimin e tyre për përFe të 20 -30 eurove për çdo tërheqje dhe gjykata duhet t'ju besojë derisa nuk disponon me ndonjë argument tjetër të besueshëm që do të vërtetonte situatë ndryshe, ashtu siç pretendohet në akuzë.

Së këndejmi, mundësia që të akuzuarit të dijnë për ligjshmërinë e Fit të parasë që ata e kishin realizuar përmes tërheqjes në WU dhe MG nuk është vërtetuar me asnjë provë, paratë i kanë tërhequr në institucione të licencuara financiare, me dokumente legale dhe, vet akti i tërheqjes së parasë nuk është i sanksionuar. Për më tepër nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë qenë në dijeni se po veprojnë në mënyrë të kundërligjshme dhe, këtë gjykata e konsideron të besueshme,

duke pas parasysh nivelin e arsimimit të mesëm të tyre dhe faktin se të njëjtit paraprakisht nuk kanë ndonjë të kaluar kriminale të ndërlidhur me shpërlarje parash.

Sa i përket faktit se të akuzuarit nuk kanë patur mundësi të dijnë se paratë burojnë nga ndonjë aktivitet kriminal, gjykata vlerëson se, të akuzuarit vërtetë nuk i kanë patur dërguesit familjar të tyre e as partner biznesi, ata ishin persona të panjohur, sikur të akuzuarit t'i kishin njohur dërguesit e parave dhe, sikur të dinin se dërguesit e parave janë të papunë, atëherë do të kishte patur mundësi të dijnë se dërguesit duke qenë në situatë jo të mirë financiare nuk mund të jenë në gjendje të dërgojnë para dikujt tjetër. Ky përceptim qoftë i saktë apo i pasaktë, nuk ka vërtetuar bindjen e gjykatës se të akuzuarit kanë qenë në dijeni për origjinën e parave të tërhequra, andaj kjo mosdije e të akuzuarve që mbetet e pavërtetuar, lë hapsirë për gjykatën që të krijojë bindje dubioze për ngjarjen dhe, në një situatë të tillë çdo dilemë e krijuar për një gjendje të tillë të fakteve do duhej interpretuar në favor të të akuzuarit. Përndryshe, derisa në rrugë institucionale nuk është vërtetuar se dërguesit vijnë nga bota e krimit, se paratë burojnë nga ndonjë aktivitet kriminal, atëherë si mund të vërtetohet gjykata se të akuzuarit kanë mund të dijnë se paratë burojnë nga ndonjë aktivitet kriminal.

Përderisa gjykata nuk ka vërtetuar elementin themeltar, atë objektiv se paratë burojnë nga ndonjë aktivitet kriminal dhe atë subjektiv se të akuzuarit kanë qenë në dijeni se pasuria-paratë burojnë nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, atëherë nuk ka arsye të elaborojë formën e kryerjes së veprës penale siç përshkruhet në paragr.1 nënpar. 1.1 e nenit 56 për shpërlarje të parasë. Paratë e tërhequra personalisht nga të akuzuarit apo përmes personave të tjerë, nuk ishin përFe të t'akuzuarve, andaj as nuk kishin patur nevojë të bënin maskimin e tyre, se si janë fituar ato para i takon vetëm autorit të shpjegojë prejardhjen e tyre, e pas maskimit duhet të rezultojë qëllimi i përdorimit të parasë si burim i ligjshëm. Mirëpo, nga provat e siguruara nga prokuroria nuk dëshmohet se të akuzuarit kanë maskuar paratë me qëllim të përdorimit të tyre të ligjshëm, meqë nuk është vërtetuar të jetë bërë ndonjë sekustrim parash të gjetura tek të akuzuarit qoftë në kesh apo në llogari bankare, apo sekuestrim i ndonjë pasurie tjetër materiale, andaj nuk mund të bëhet fjalë as për maskim apo konvertim të pasurisë.

Rrjedhimisht provat e administruara siç janë provat materiale, por edhe dëshmitë e dëshmitarëve nuk kanë qenë inkriminuese për tani të akuzuarit, ato vetëm sa përshkruajnë aspektet teknike të tërheqjes së parave në WU dhe MG.

Andaj, gjykata vlerëson se, me asnjë provë relevante nuk u vërtetua asnjëri nga faktet vendimtare të cilat dëshmojnë dhe provojnë elementet e veprës penale Shpërlarja e parave nga neni 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit 05/L-096 dhe nga këto arsye ndaj tani të akuzuarve mori aktgjykim lirues.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paraqitura nga prokuroria, mirëpo këto pretendime i gjeti të pabazuara pasi që nuk mbështeten në asnjë provë konkrete që do të vërtetonte ekzistimin e elementeve objektive dhe subjektive të veprës penale të shpërlarjes së parave, përfshirë edhe pretendimin se të akuzuarit kanë tërhequr të gjitha paratë sipas aktakuzës për vete, të cilin gjykata nuk e vlerësoi të qëndrueshëm, ngase nuk pati provë për t'a bazuar këtë pretendim, ato para nuk patën asnjë gjurmë, të akuzuarit vërtetë kishin tërhequr para por përFet e realizuara ishin në shuma të vogla thuajse sikur edhe dëshmitarët edhe pse këta të fundit nuk ishin fare të akuzuar.

Gjykata konstaton se për nxjerrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm, përgjegjësia penale e çdo të akuzuari duhet provuar në mënyrë të plotë, askush nuk mund të shpallet fajtor në bazë të supozimeve, pa pasur prova të qarta dhe bindëse të cilat e vërtetojnë me saktësi ekzistimin e fakteve përkitazi me kryerjen e veprës penale. Pra, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen duhet interpretuar në favor të t'akuzuarit dhe të drejtave të tij në mbështetje të nenit 3 par. 2 të KPP *In dubio pro reo*, ku thuhet se: *Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas KPP dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, andaj meqenëse në rastin konkret provat në të cilat prokuroria e ka mbështetur aktakuzën janë të pamjaftueshme, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për lirim nga shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPP.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, dhe në mbështetje të neneve 358 dhe 363 të KPP, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI SPECIAL**

**PS.nr.33/21, datë 24.04.2023**

**Vanesa Rama**  
**Zyrtare ligjore**

**Suzana Çerkini**  
**Kryetare e trupit gjykues-gjyqtare**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë ditësh (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë